

VENDIM
Nr. 214, datë 15.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 200, DATË 12.12.2019

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, nenit 20, germa “c”, nenit 83 dhe nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “c”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve nr. 132/8 prot., datë 11.12.2020, në lidhje me lënien në fuqi të vendimit nr. 200, datë 12.12.2019,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 10.1.2020, ka miratuar fillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për klientët që shërbehen nga FSHU sh.a., për vitin 2020.

- Me shkresën e ERE-s nr. 201, datë 27.1.2020, u është kërkuar opinionin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 2, datë 10.1.2020, palëve të interesuara si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti i Konkurrencës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike.

- ERE, në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, ka pasur një sërë korrespondencash lidhur me plotësimet e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., si dhe dhënien e argumenteve plotësues mbi komponentët e përcaktimit të tarifave të rrjetit të shpërndarjes, si dhe çmimeve të shitjes me pakicë.

- Në vijim të situatës së paprecedentë të krijuar nga pandemia COVID-19, për shkak të pamundësisë për zbatimin e parashikimeve të legjislacionit në fuqi sa i përket diskutimit publik e organizimit të seancave dëgjimore me palët e interesit, masave kufizuese të marra nga Qeveria Shqiptare për kufizimin e përhapjes së virusit COVID-19, si dhe në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “c”, nenit 85, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”; nenit 67 dhe 91, pika 4, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, neneve 15 dhe 22, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”; Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 67, datë 8.4.2020, vendosi pezullimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për klientët që shërbehen nga ky i fundit, për vitin 2020, dhe shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit, për vitin 2020, deri jo më vonë se 3 muaj nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë.

- Shoqëria FSHU sh.a. nuk ka mundur të paraqesë informacionin e kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, me anë të një sërë korrespondencash nga ana e ERE-s, lidhur me realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar të shoqërive, përgjatë vitit 2020.

- Parashikimet e shoqërisë FSHU sh.a., të paraqitura në kërkesën për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për vitin 2020, për të cilën me vendimin nr. 2, datë

10.1.2020, Bordi i ERE-s ka miratuar fillimin e procedurës, nuk mund të merren për bazë për arsye se tashmë jemi në muajin e fundit të vitit 2020, ndaj çdo e dhënë e depozituar më herët ka humbur aktualitetin dhe nuk paraqet një pasqyrë reale të rrethanave të faktit.

- Nga vlerësimet e kryera mbi të dhënat e vëna në dispozicion, në kuadër të raportimeve periodike, llogaritet se tarifat aktuale të çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike i mundësojnë shoqërisë FSHU sh.a. të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve nga aktiviteti i licencuar.

- Metodologjitë për llogaritjen e tarifave për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU), të miratuara nga ERE, bëjnë të mundur korrigjimin e të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar, për të ardhura për vitin paraardhës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së nisur me anë të vendimit nr. 2, datë 10.1.2020, për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a., për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë, për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, për vitin 2020.

2. Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 200, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi, mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., për vitin 2021, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e shoqërisë FSHU sh.a., korrigjimi i tyre do të bëhet mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës, sipas përcaktimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 7, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë të klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)” të miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2021.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti